



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KRYETARI

Nr/869 prot

Lib më 05/04/2023

VENDIM

Nr 03 datë 05/04/2023

**“PËR PËRCAKTIMIN E VENDEVE PUBLIKE NË TERRITORIN E BASHKISË
LIBRAZHD PËR AFISHIMIN NGA ANA E SUBJEKTEVE ZGJEDHORE TË
MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE PËR FUSHATËN ZGJEDHORE TË
ZGJEDHJEVE TË DATËS 14.05.2023”**

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar , nenin 79 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin e KQZ Nr. 6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, ,nenin 9 të Vendimit Nr.12, datë 30.12.2020 “Për miratimin e rregullave të veprimtarisë së Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve”, si dhe shkresën Nr 1033 prot date 21.02.2023.

VENDOSA:

1. Për afishimin e materialeve propagandiste nga subjektet zgjedhore:

a) Për Partinë Socialiste

Vendndodhja : Godina bashkia Librazhd, Kati i 1-re

ZK:2446

Adresa: Sheshi Gjorg Golemi, Librazhd

Përshkrimi : Fasade

<https://goo.gl/maps/i3hdiRVCoyNEFoi16>

b) Për partinë Demokratike

Vendndodhja : Godina bibliotekes, Kati I 2-te

Adresa: Rruga Arberia, Bashkia Librazhd

ZK:2446

Përshkrimi : Fasade

<https://goo.gl/maps/FMZt35xnFFcfprxU9>

2. Partitë që nuk kanë Seli ti vendosin në Zyrat Elektorale
3. Hapësirat për secilën parti politike dhe subjekt zgjedhor, duhet të jenë sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor.
4. Përdorimi dhe afishimi i çdo materiali statik për propagandë zgjedhore, përfshirë flamujt dhe posterat, lejohen vetëm në largësi deri 5 m nga zyra zgjedhore e partisë apo subjektit zgjedhor përkatës.
5. Të gjithë materialet propagandistike vizive që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të..... “ (vijon emri i subjektit zgjedhor).
6. Ndalohet afishimi i materialeve në fazadat e godinave të banimit, institucionet publike apo ambientet rrethuese pranë tyre, Brenda zonave rekreative, parqeve në pemët e qytetit dhe shtyllat e ndriçimit.
7. Një kopje e këtij vendimi i komunikohet subjekteve zgjedhore.
8. Me marrjen dijeni të këtij vendimi subjektet zgjedhore brënda 5 ditëve kanë detyrim të japin informacion për adresat e sakta të zyrave elektorale dhe të bëhet verifikimi i tyre.
9. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Policia Bashkiake
10. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

Kastriot GURRA

